 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universitet Prizren <b>"UKSHIN HOTI"</b>	
Pranuar me dt. 06.04.2020	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-108



**UNIVERSITETI-UNIVERSITY**  
**"UKSHIN HOTI"**  
**KËSHILLI DREJTUES**

**RAPORT I PUNËS**  
**2019**

MARS, 2020  
 PRIZREN

## Përmbajtje

FJALA HYRËSE.....	3
ORGANOGRAMI.....	5
OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE.....	6
BURIMET, OBJEKTET E MËSIMNXËNIES DHE BIBLIOTEKA.....	8
PERSONELI AKAEMIK DHE ADMINISTRATIV.....	9
NUMRI I STUDENTËVE.....	11
PASQYRA E NUMRIT TË STUDENTËVE TË RREGULLT (AKTIV) PËR VITIN AKADEMIK 2019/2020 , DHE SIPAS VITEVE TË PRANUAR NE VITIN E PARË.....	11
BACHELOR DHE MASTER.....	11
NUMRI I KANDIDATËVE TË DIPLOMUAR NË STUDIMET BACHELOR PREJ.....	14
1 TETOR 2016 DERI 2019.....	14
NUMRI I KANDIDATËVE TË DIPLOMUAR NE NIVELIN MASTER PREJ 1 TETORI 2016 DERI 2019.....	16
RAPORTI STUDENT-PROFESOR.....	17
BRAKTISJA E STUDIMEVE.....	17
QENDRA E KARRIERËS & ALUMNIT.....	18
PROGRAMET E STUDIMIT, KËRKIMI SHKENCOR.....	19
STUDIMET DOKTORATURËS.....	20
KËRKIMI SHKENCOR.....	20
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	23
PROJEKTET AKTIVE.....	24
ZHVILLIMI DHE ZBATIMI I NJË PROGRAMI PHD NË TIK PËR SISTEMIN EDUKATIV TË KOSOVËS 2019-22.....	25
KRIJIMI I QENDRAVE NGA TEORIA NË PRAKTIKË PËR INOVACION DHE PUNËSIM 2017-20 .....	25
SMART4ALL.....	26
PËRMIRËSIMI I KULTURËS SË KËRKIMIT NË ARSIMIN E LARTË NË KOSOVË – RESEARCHCULT 2019-22.....	26
ZHVILLIMI CILËSOR I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR DHE MENAXHIMIT TË PROJEKTIT QUADIC 2019-22.....	27
KONFERENCAT NË RANG KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR.....	28
MOBILITETI I STAFIT DHE STUDENTEVE.....	28
SIGURIMI DHE NGRITJA E CILËSISË.....	30
BORDI KËSHILLËDHËNËS INDUSTRIALE.....	31
BUXHETI, FINANCAT DHE INFRASTRUKTURA.....	31
<b>PLANET STRATEGJIKE DHE RREGULLORET QË JANË HARTUAR GJATË VITIT 2019.</b>	<b>32</b>
INFRASTRUKTURA.....	34
HAPËSIRA INFRASTRUKTURE PËR NJË STUDENT.....	34

## **FJALA HYRËSE**

Si çdo vit edhe për vitin 2019, Këshilli Drejtues publikon raportin vjetor për përmbushjen e detyrave të punës së Universitetit për të paraqitur punën e bërë. Në këtë Raport vjetor të punës për vitin 2019, paraqiten të dhënat e përmbledhura për Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, objektivat e përgjithshme strategjike të arritura; të dhënat statistikore për tërë Universitetin dhe njësitë e tij akademike dhe organizative në lidhje me burimet: buxheti (fondet publike dhe private); personeli (shifrat zhvillimore); infrastruktura; profili akademik (ndryshimet në personelin akademik, fushat e studimit etj.); programet e studimit; numrin e studentëve (studentët e regjistruar për herë të parë, numri i përgjithshëm i studentëve, të diplomuarit); kërkimet shkencore (projektet, publikimet, pjesëmarrja në konferenca, punimet), bashkëpunimin ndërkombëtar në Sigurimin e Cilësisë.

Viti 2019 ka qenë vit i sfidave për Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, pasi që këtë vit kemi marr vendim negativ për riakreditim institucional. Po ashtu këtë vit është bërë ndërrimi i strukturave menaxhuese të Universitetit, një proces ky i stërzgatur dhe i përcjellur me shumë vështirësi. Mirëpo viti 2019, ka qenë vit edhe i mundësive për plotësimin e standardeve të reja të përcaktuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Agjencia Kosovare e Akreditimit në fund të vitit 2018. Prioritet i Universitetit gjatë këtij viti ka qenë plotësimi i rekomandimeve të Grupit të Ekspertëve Ndërkombëtar të paraqitura në Raportin Final dhe të gjitha standardeve të përcaktuara në Manualin e Akreditimit. Duke falënderuar strukturat udhëheqëse dhe të gjithë stafin në veçanti, në këtë vit janë bërë punë të mëdha për përcaktimin e të ardhmes së Universitetit. Këtë vit kemi rishikuar misionin dhe vizionin dhe kemi përcaktuar objektivat strategjike për pesë vitet e ardhshme që paraqiten një punë voluminoze dhe premtuese për të ardhmen e këtij Universiteti. Prioritet mbi prioritetet ka qenë themelimi dhe funksionalizimi i strukturave për sigurimin e cilësisë, duke përcaktuar instrumentet për vlerësimin e të gjitha shërbimeve që ofron Universiteti me qëllim të gjetjes së çalimeve të cilësisë dhe ndërmarrjen e masave për përmirësimin e situatës. Është punuar shumë në funksion të ruajtjes dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe hulumtim shkencor, në përmirësimin e shërbimeve për studentët dhe krijimit të kushteve më të mira për stafin akademik dhe administrativ, si dhe lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete tjera në rajon dhe Evropë.

Duke analizuar secilin standard të njëmbëdhjetë kapitujve të këtij manuali, kemi hartuar planin e implementimi të rekomandimeve të AKA-së. Ky plan dinamik është dorëzuar në AKA dhe ka

shërbyer si udhërrëfyes për punën e Universitetit në përmbushjen e standardeve dhe përgatitjen e procesit të akreditimit.

Përpos miratimit të planit të ri strategjik dhe plotësim-ndryshimin e misionit të Universitetit, është bërë ristrukturimi institucional, funksionalizimi dhe përforcimi i zyrave si: Zyra për Sigurimin e Cilësisë, Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Zyra e Projekteve, Qendra e Karrierës&Alumnit. Pastaj Plotësimi dhe Ndryshimi Kodit të Etikës, hartimi i Rregullores për Sigurimin e Cilësisë, Udhëzuesi për Vlerësimin e Lëndës dhe Mësimdhënësve, themelimi i Komisionit Qendror për Sigurimin e Cilësisë, themelimi i Komisioneve për Sigurimin e Cilësisë në nivel të fakulteteve, Draftimi i RVsë, përkthimi i të gjitha dokumenteve, rregulloreve në gjuhën angleze, plotësim-ndryshimi i Rregulloreve për studime bachelor dhe master, Rregullorja për Universitetin Veror Ndërkombëtar, Rregullorja e punës së Senatit, Rregullorja e SMU-së, Hartimi i Planit Strategjik për Veprimtarinë kërkimoro-shkencore, Hartimi i Rregullores për Kërkime Shkencore, Doracaku për Stafin Akademik dhe Administrativ, Draftimi i Doracakut për Studentë, Anëtarësimi i bibliotekës në asociacionin e bibliotekave elektronike, rritja e bashkëpunimit posaçërisht me pushtetin lokal dhe bizneset lokale, hartimi i Rregullores për themelimin dhe parimet e funksionimit të Bordit Këshillëdhënës Industrial dhe konstituimin e BKI-së nëpër të gjitha njësitë akademike. Pastaj është bërë edhe hartimi i Strategjisë për Ndërkombëtarizim. Po ashtu kemi filluar punën për instalimin e softuerit antiplagjiat. Gjatë vitit 2019, është bërë edhe publikimi i të gjitha dokumenteve dhe rregulloreve në web-faqen zyrtare të Universitetit në gjuhën shqipe e angleze dhe funksionalizimi i versionit në gjuhën angleze të web-faqes dhe shumë punë të tjera të rëndësishme.

Një falënderim i veçantë shkon për Rektorin Temaj, stafin e tij menaxhues dhe gjithë personelin akademik dhe administrativ të cilët kanë qenë në krye të detyrës së tyre për ndërtimin e të ardhmes e këtij Universiteti dhe partnerët vendor dhe ndërkombëtar që na kanë mbështetur gjatë këtij viti.


Me respekt,

Prof.Asoc.Dr. Bedri Muhadri

Kryesues i Këshillit Drejtues

# ORGANOGRAMI

## Organogrami i Universitetit "UKSHIN HOTI" Prizren



## **OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE**

Në Planin Strategjik 2018-22, në Universitetin “Ukshin Hoti” janë përcaktuar tetë objektiva strategjike. Në secilën prej këtyre objektivave strategjike është punuar gjatë kësaj periudhe dhe janë arritur rezultate bazuar në burimet dhe mundësitë, mirëpo në Raportin Final të grupit të ekspertëve ndërkombëtar për riakreditim institucional janë dhënë vërejtje serioze sa i përket këtij Planit Strategjik.

Bazuar në Raportin e Grupit të Ekspertëve Ndërkombëtar dhe në Manualin e Akreditimit të AKA-së, gjatë pjesës së dytë të vitit 2019 kemi formuar grupet punese për adresimin e rekomandimeve dhe përmbushjen e standardeve, dhe si rrjedhojë kemi rishqyrtuar misionin, vizionin dhe objektivat institucionale duke nxjerr një Plan të ri strategjik në përputhje të plotë me standardet dhe duke konsultuar të gjithë akterët e brendshëm dhe të jashtëm dhe është një përtëritje e planit të kaluar duke marr pjesët më të mirat, por është hartuar një dokument i kompletuar me të gjitha elementet përbërëse.

Ky plan strategjik është hartuar duke u mbështetur në Standardet dhe Udhëzuesit për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, Ligjin 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, Standardet e Udhëzuesit të Akreditimit në Agjencinë Kosovare të Akreditimit (AKA), Rekomandimet e Grupit të Ekspertëve Ndërkombëtar, pas një konsultimi gjithëpërfshirës të akterëve të jashtëm dhe të brendshëm. Pjesë e këtij plani është edhe Plani i Veprimit dhe Plani Financiar. Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 31 dhjetor 2019, miratoi Planin Strategjik për vitet 2020-2024. Të gjitha aktivitetet zhvillimore të Universitetit do të mbështeten dhe udhëhiqen nga ky plan strategjik.

Plani Strategjik i Universitetit 2020-2024 ndërtohet në kornizën e 7 (shtatë) objektivave strategjike: Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie; Zhvillimi i punës kërkimoro-shkencore; Kontributi në komunitet; Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit; Zhvillimi i infrastrukturës; Digjitalizimi dhe sistemi i integruar i të dhënave; dhe Qëndrueshmëria financiare. Këto objektiva strategjike zërthehen në rezultatet e pritura për Universitetin.

## Objektivat strategjike

Planit Strategjik 2020-2024  
ka identifikuar këto  
objektiva strategjike.



Figura 1: Objektivat strategjike të Universitetit

## **Burimet, objektet e mësimnxënies dhe biblioteka**

Universiteti ofron rreth 60,000 libra në të dy bibliotekat e Universitetit. Ai përfshin të gjitha fushat që ofrohen aktualisht në Universitet, përfshirë Edukimin, Filologjinë, Ekonominë, Juridikun, Shkencat e Jetës. Ka libra në shumë gjuhë, përfshirë gjuhën shqipe, gjuhën boshnjake, gjuhën turke, gjuhën angleze dhe gjuhën gjermane të cilat përdoren kryesisht nga Departamenti i Gjuhës Gjermane. Në baza vjetore, Universiteti blen libra bazuar në nevojat e departamentit. Çdo vit biblioteka kërkon nga departamentet që të bëjnë një listë me tituj të botimeve për të cilat kanë nevojë dhe përgatit një kërkesë për prokurim. Për më tepër, në bashkëpunim me partnerët dhe në kuadër të projekteve të ndryshme, për shembull, Projekti Tempus, Universiteti ka financuar blerjen e mbi 1300 librave. Nga ky fond i librave, 590 tituj janë në gjuhën shqipe, 480 në gjuhën angleze, 130 në gjuhën gjermane dhe 100 në atë turke. Biblioteka e Universitetit ka pranuar gjithashtu mbi 4500 libra nga Austria. Nga ky dhurim i librave, 2,000 kopje janë në gjermanisht, ndërsa 2.500 të tjera janë në gjuhën angleze. Në marrëveshje me Institutin Pedagogjik të Kosovës, bibliotekës i janë siguruar 238 kopje të botimeve të Institutit. Istanbul Medipol Üniversitesi ka dhuruar 100 kopje librash nga Turqia. Instituti Albanologjik i Prishtinës vazhdimisht po dhuron libra të rinjë në Universitetin e Prizrenit. Instituti për Ruajtjen e Monumenteve dhuron edhe botimet e tij për nevojat e bibliotekës së Universitetit. Librat e tjerë në bibliotekën e Universitetit përbëjnë një nga koleksionet më të pasura dhe më të rralla në Kosovë. Më në fund, fondi i librave në gjuhën gjermane përfshin 4,000 libra dhe fondi i librave në gjuhën angleze përfshin mbi 3500 libra.

Universiteti ka një organizim dhe menaxhim të strukturuar mirë të bibliotekës së Universitetit. Ka tre anëtarë të stafit të punësuar me kohë të plotë, duke përfshirë drejtorin e bibliotekës dhe dy bibliotekarë me kohë të plotë që ofrojnë shërbime në dy biblioteka të Universitetit. Shërbimet e ofruara në bibliotekë vlerësohen vazhdimisht duke përdorur pyetësorë dhe bazuar në rezultate, zyra e burimeve njerëzore përgatit një plan për zhvillimin e kapaciteteve të stafit të punësuar në bibliotekë. Biblioteka Universitare është gjithashtu pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të shërbimeve të ofruara në Universitet. Studentët dhe stafi mësimor pyeten për gjendjen e përgjithshme në bibliotekë, përfshirë shërbimin. Duke u bazuar në rezultate, është bërë një plan i qartë i zhvillimit dhe çështjet janë adresuar.

Universiteti i Prizrenit ka qasje të besueshme dhe efikase në bazat e të dhënave online. Disponueshmëria e qasjes në revistat përkatëse është përmirësuar ndjeshëm pas marrëveshjes



me Bibliotekën Universitare të Prishtinës për t'u bërë anëtare e Shoqatës së Bibliotekave Elektronike të Kosovës. Kjo bazë e të dhënave elektronike gjithashtu mundëson zhvillimin e punës kërkimore të studentëve dhe stafit akademik. Atyre u ofrohet qasje dhe disponueshmëri e librave, revistave shkencore, raporteve profesionale dhe materialeve të tjera kërkimore. Universiteti ka edhe marrëveshje të tjera duke përfshirë Bibliotekën e Universitetit të Prishtinës, Bibliotekën Kombëtare, Shoqatën e Bibliotekave Elektronike të Kosovës dhe Bibliotekën e Komunës së Prizrenit. Të gjitha këto marrëveshje sigurojnë që studentët tanë të jenë në gjendje të përdorin, nëse është e nevojshme, burimet nga biblioteka e partnerit tonë. Marrëveshjet e nënshkruara mund të gjenden në shtojcën e këtij raporti. Këtu janë burimet që përfshijnë marrëveshjen me Shoqatën e Bibliotekave Elektronike të Kosovës:


#### **PERSONELI AKAEMIK DHE ADMINISTRATIV**

Personeli i rregullt i Universitetit në total është 120 punonjës (personel akademik dhe administrativ). Në vitin 2019 janë rekrutuar 18 punonjës të rinjë.


Prof.dr.	total 0	të rekrutuar në 2019-(0)
Prof. asoc. dr.	total 17	të rekrutuar në 2019-(2)
Prof. ass. dr.	total 43	të rekrutuar në 2019-(8)
Asistent	total 19	të rekrutuar në 2019-(6)

Personel administrativ: totali 41, të rekrutuar në 2019 - (2)

### Personeli akademik sipas gjinisë (2019)



### Stafi mbështetës administrativ dhe teknik (2019)



## NUMRI I STUDENTËVE

Nga viti në vit, ka shkuar duke u rritur interesimi për të studiuar në Universitetin tonë, dhe aktualisht i kemi 4035 studentë aktiv.

Në vitin akademik 2019/2020 nuk kemi regjistruar studentë të rinjë për shkak të mos akreditimit institucional edhe pse programet kanë qenë të akredituara.

Më poshtë mund të gjeni disa të dhëna statistikore të krijuara jashtë platformës së SMU-së.

**Pasqyra e numrit të studentëve të rregullt (aktiv) për vitin akademik 2019/2020 , dhe sipas viteve të pranuar ne vitin e parë**

## BACHELOR DHE MASTER

Departamenti-Dega-Seksioni	Të rregullt V. A. 2019/20							Gjithsej	2016/17	2017/18	2018/19	2019/20	Gjithsej
	Gjina	I	II	III	IV								
ADMINISTRIM BIZNESI	F	10	98	147				255	128	163	138		429
	GJ	36	155	229				420	303	258	296		857
MENAXHMENT NDËRKOMBËTAR/ VI MASTER TRASHËGIMIA KULTURORE/	F	9	79	80				168	79	91	112		282
	GJ	15	127	125				267	192	184	224		600
JURIDIK	F	8	144	166	146			464	198	221	150		569
	GJ	17	199	227	218			661	421	262	251		934
SOFTWARE DESING / VI-MASTER SHKENCAT KOMPJ/	F	2	23	25				50	14	18	29		61
	GJ	17	63	73				153	125	105	134		364
TIT	F	5	18	51				74	28	30	24		82
	GJ	19	45	111				175	166	102	101		369
TIT – BOSHNJAK	F	0	5	5				10	10	10	5		25
	GJ	2	16	14				32	37	14	32		83
TIT /TUR/	F	7	3	0				10	10	8	10		28
	GJ	9	6	3				18	37	15	23		75

EDUKIMI -GJUHË GJERMANE	F							0	0	0			0
	G J							0	0	0			0
GJUHË SHQIPE	F							0	0	0			0
	G J							0	0	0			0
KIMI-FIZIKË	F							0	0	0			0
	G J							0	0	0			0
HEMIJA-FIZIKA /BOS/	F							0	0	0			0
	G J							0	0	0			0
EDUKIMI -GJUHË ANGLEZE	F							0	0	0			0
	G J							0	0	0			0
PROGRAMI FILLOR	F	2	92	161	281			536	309	101	86		496
	G J	2	102	180	314			598	349	113	99		561
OSNOVNI PROGRAM	F	0	10	19	18			47	24	25	10		59
	G J	0	14	22	28			64	43	31	17		91
PROGRAMI FILLOR / TUR/	F	2	9	7	11			29	12	18	11		41
	G J	3	13	13	15			44	25	21	17		63
PROGRAMI PARAFILLOR	F	7	90	102	253			452	187	107	96		390
	G J	7	91	105	255			458	189	107	99		395
PROGRAMI PARAFILLOR/ BOS/	F	0	7	5	9			21	8	10	9		27
	G J	0	7	6	11			24	12	10	9		31
PROGRAMI PARAFILLOR/TUR/	F	7	16	14	10			47	22	17	19		58
	G J	7	16	15	11			49	25	17	19		61
KIMI-FIZIKË /GJUHË TURKE/	F							0	0	0			0
	G J							0	0	0			0
MATEMATIKË- INFORMATIKË/ BOS/	F							0	0	0			0
	G J							0	0	0			0
MATEMATIKË- INFORMATIKË/TUR/	F							0	0	0			0
	G J							0	0	0			0
BOSANSKI JEZIK	F							0	0	0			0
	G J							0	0	0			0
FILOLOGJIK - GJUHË SHQIPE	F	16	57	126				199	91	95	78		264
	G J	18	62	152				232	131	109	95		335
FILOLOGJIK - GJUHË ANGLEZE	F	4	66	70	99			239	145	92	70		307
	G J	8	87	81	117			293	206	102	96		404
FILOLOGJIK - GJUHË GJERMANE	F	3	51	44	37			135	89	103	63		255
	G	6	68	57	47			178	153	117	99		369

	J												
SHKENCAT E PYJEVE DHE MJEDISIT	F	0	15	7				23	9	28	15		52
	G												
	J	2	29	32				63	67	50	50		167
AGROBIZNES	F	1	10	7				18	11	0	16		27
	G												
	J	3	26	18				47	53	0	49		102
MASTER ADMINISTRIM BIZNESI	F	4	54					58			25		25
	G												
	J	9	92					101	115	61	59		235
MASTER AUDITIM	F	3	51					54			34		34
	G												
	J	4	83					87	98	61	60		219
MASTER TRASHËGIMIA KULTURORE	F	0	0					0					
	G												
	J	0	0					0	49	0			49
MASTER SHKENCAT KOMPJUTERIKE	F	3	29					32			15		15
	G												
	J	12	59					71	62	50	46		158
GJITHSEJ	F	93	927	1036	864	0		2920	137	113	101		352
	G	19			101				4	7	5		6
	J	6	1360	1463	6	0		4035	285	178	187		652
								8	9	5			2

**Numri i kandidatëve të diplomuar në studimet Bachelor prej**

**1 tetor 2016 deri 2019**

Nr.	Departamenti-Dega-Drejtimi	2016/17			2017/18			2018/19			2019/20		
		M	F	Totali	M	F	Totali	M	F	Totali	M	F	Totali
1	Edukim fillor	9	101	110	5	122	127	19	123	142	15	143	153
2	P.Fillor-Gj.turek	0	1	1	0	1	1	3	14	17	4	13	17
3	P.Fillor-Gj.Boshnjake	3	13	16	6	13	19	6	26	32	4	11	15
4	Edukimi parashkollor-Gj.shqipe	0	67	67	0	60	60	1	100	101	1	85	86
5	Programi Parashkollor Gj.Boshnjake	0	0	0	0	14	14	0	1	1	0	4	4
6	Programi Parashkollor Gj.Turke	0	9	9	0	8	8	0	21	21	0	15	15
7	Mat-informatikë	8	17	25	1	4	5	1	3	4			
8	Mat-Informatikë-Turqisht	4	4	8	4	8	12	2	1	3	3	0	3
9	Kimi –fizikë, Boshnjakisht	4	2	6	3	4	7						
10	Kimi-Fizikë Turqisht	2	6	8									


11	Kimi-Fizike Shqip Gjuhe Angleze Edukim	2	8	10	3	6	9	1	4	5	1	1	2
12	Gjuhë Shqipe Edukim	4	34	38	5	23	28	2	3	5	0	2	2
13	Bosanski jezik Edukim	9	38	47	0	3	3	0	1	1	0	0	0
14	Juridik	7	1	8	0	1	1	0	1	1	1	1	2
15	FSHK -TIT	63	96	159	45	51	96	50	82	132	45	104	149
16	FSHK-DIZAJN SOFTWERI	34	34	68	39	43	82	35	30	65	5	8	13
17	GJ.BOSHJAKE	17	13	30	20	16	36	28	23	51	15	4	19
18	FSHK-TIT- GJ.TURKE	0	8	8	4	9	13	11	7	18	8	6	14
19	Administrim biznesi	0	0	0	1	0	1	2	7	9	0	2	2
20	Menaxhment ndërkombëtar	45	103	148	27	71	98	24	53	77	18	37	55
21	F.FILO. GJUHE SHQIPE	63	93	156	35	58	93	33	36	69	16	27	43
22	F.FILO. GJUHE ANGLEZE	1	1	2	1	19	20	2	24	26	9	54	63
23	F.FILO. GJUHE GJERMANE	3	8	11	5	9	14	8	18	26	1	2	3
24	FSHJMJ- AGROBIZNES	0	0	0	0	0	0	0	2	2	2	2	4
25	FSHJMJ- SHK.NATYRORE DHE MEJDISI	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5	2	7
26													
27													
28													
29	GJITHSEJ			935			747			854			685

**Numri i kandidatëve të diplomuar ne nivelin master prej 1 tetori 2016 deri 2019**


N r.	Departamenti-Dega-Drejtimi	2016/17			2017/18			2018/19			2019/20		
		Mes hkuj	Femra	Gjithsej	Mes hkuj	Femra	Gjithsej	Mes hkuj	Femra	Gjithsej	Mes hkuj	Femra	Gjithsej
1	Trashëgimia kult. dhe men. I turizmit	0	0	0	0	0	5	0	0	38	0	0	16
2	FSHK	5	1	6	7	10	17	18	15	33	1	11	12
3	ADMINISTRIM BIZNESI	0	0	0	0	0	24	0	0	75	0	0	20
4	AUDITIM	0	0	0	0	0	9	0	0	55	0		24
5				0			0			0			0
6				0			0			0			0
7				0			0			0			0
8				0			0			0			0
9				0			0			0			0
10				0			0			0			0
11				0			0			0			0
12				0			0			0			0
	<b>GJITHSHEJ</b>			6			55			201			72



## Raporti Student-Profesor



## Braktisja e studimeve



## **Qendra e Karrierës & Alumnit**

Universiteti gjatë vitit 2019 ka themeluar Qendrën e Karrierës & Alumnit dhe ka aprovuar Rregulloren për themelimin dhe organizimin e Qendrës së Karrierës & Alumnit. Kjo Rregullore definon dhe përcakton misionin, vizionin, organizimin, qëllimin, funksionet, përgjegjësitë, kompetencat dhe detyrat e QKA-së. Misioni i QKA-së është të ndihmojë studentët që të zhvillojnë aftësi punësimi dhe të shërbejnë si një urë ndërlidhëse midis Universitetit dhe studentëve të diplomuar.

Gjastë këtij viti kemi hartuar Doracakun e Studentëve. Doracaku për studentë është një përmbledhje e Statutit dhe Rregulloreve të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, të cilat rregullojnë statusin e studentit si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tij. Ky doracak do të jetë udhëzues i akteve të Statutit, i akteve ligjore dhe nënligjore të lëshuara nga MASHT-i, dhe i Manualit të Agjencionit dhe Akreditimit të Kosovës. Doracaku është përmbledhja e informacioneve për studentë gjatë gjithë ciklit të studimeve, pra studenti që të jetë më afër informacionit dhe të ketë një adresë ku mund të marrë informacione sa më të sakta për veten e tij.

## PROGRAMET E STUDIMIT, KËRKIMI SHKENCOR

Aktualisht në Universitetin “Ukshin Hoti” kemi 6 (gjashtë) fakultete me gjithsej 21 (njëzetë e një) programe, në nivelin bachelor dhe master.

	Programet e studimit	Niveli	ECTS	akredituar deri
1.	Administrim Biznesi	Bsc	180	2022
2.	Dizajn i Sovtverit	BSc	180	2022
3.	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	BA	240	2021
4.	Juridik	LLB	240	2022
5.	Kontabilitet dhe Auditim	MSc	120	2021
6.	Menaxhimi Ndërkombëtar	BSc	180	2022
7.	Shkencat kompjuterike dhe teknologjitë e komunikimit	Msc	120	2021
8.	Teknologjitë e informacionit dhe telekomunikacion	BSc	180	2022
9.	Teknologjitë e informacionit dhe telekomunikacion – Boshnjakisht	BSc	180	2022
10.	Teknologjitë e informacionit dhe telekomunikacion – Turqisht	BSc	180	2022
11.	Arsimi parashkollor	BA	240	2022
12.	Arsimi fillor	BA	240	2022
13.	Arsim parashkollor	BA	240	2022
14.	Arsim fillor	BA	240	2022
15.	Arsim parashkollor	BA	240	2020
16.	Arsim fillor	BA	240	2020
17.	Shkencat e Pyjeve dhe të Mjedisit	BSc	180	2020
18.	Agrobiznes	BSc	180	2020
19.	Gjuhë dhe letërsi shqipe	BA	240	2020
20.	Gjuhë dhe letërsi gjermane	BA	180	2020
21.	Administrim biznesi	MSc	120	2020

## **Studimet doktoraturës**

Njëkohësisht, brenda një periudhe afatmesme, Universiteti planifikon të hap edhe programet e studimeve të doktoratës. Në funksion të përmbushjes së këtij objekti, Universiteti është pjesë e projektit ndërkombëtar DIPHDICTKES (The development and implementation of PhD Curricula in ICT for Kosovo Education System) nën udhëheqjen e dy universiteteve prestigjioze, Linnaeus University (LNU, Suedi) dhe NTNU (Norwegian University of Science and Technology, Norvegji).

## **Kërkimi shkencor**

Universiteti ka një plan të përgjithshëm strategjik i cili përfshin gjithashtu planin dhe qëllimet e hulumtimit. Plani dinamik i detajuar është bashkëngjitur dhe përcakton qartë veprimet dhe koston e aktiviteteve hulumtuese për pesë vitet e ardhshme 2020-2024. Po ashtu Universiteti ka hartuar Planin Strategjik për hulumtime edhe Rregulloren për kërkime shkencore ku përcaktohen kriteret dhe stimulimi nga Universiteti për ata që punojnë. Të gjitha këto punë janë bërë gjatë vitit 2019.

Hulumtimi është në përputhje me nevojat rajonale dhe misionin e Universitetit. Statuti i Universitetit përcakton qartë kriteret e profesorëve për sa i përket botimeve dhe pasojave për profesorët që nuk botojnë rregullisht. Siç u përmend në raportin nga ana e hulumtimit, objektivi kryesor i planit të zhvillimit të Universitetit është edhe hulumtimi.

Në këtë seksion të faqes në internet do të gjeni bazën e të dhënave e të gjitha punëve kërkimoro-shkencore të stafit të rregullt akademik të Universitetit tonë në fakultetet përkatëse:

## Databaza e publikimeve shkencore

### FAKULTETI I SHKENCAVE

#### KOMPJUTERIKE

- Samedin Krrabaj
- Arsim Susuri
- Ercan Canhasi
- Ziriye Hasani
- Naim Baftiu
- Malush Mjaku
- Dhurata Hyseni
- Agon Koka
- Betim Maloku
- Arbër Beshir
- 

### FAKULTETI I SHKENCAVE TË

#### JETËS DHE MJEDISIT

- Isuf Lushi
- Albana Plaqiqi Milaimi
- Ylli Kortoci
- Ekrem Gjokaj
- Kushtrim Braha
- Faruk Bojaxhi
- Sadik Maloku
- Nol Krasniqi
- Lidiron Buqaj

### FAKULTETI I EDUKIMIT

- Fahredin Shabani
- Ismet Temaj
- Soner YILDIRIM
- Elsev Brina
- Vedat Bajrami
- Ragip Gjoshi
- Münevver YILDIRIM
- Bajram Cupi
- Shemsi Morina
- Rifat Morina
- Fatmir Mehmeti
- Serdan Kervan
- Ajka Aljilii
- Albulena Alidema
- Artan Reshani
- Pranvera Jetishi-Collaku

### FAKULTETI EKONOMIK

- Halil Kukaj
- Hamdi Hoti
- Gani Gjini
- Bexhet Brajshori
- Bekim Berisha
- Artan Nimani
- Shukri Maxhuni
- Hysni Terziu
- Floriye Govori
- Nerimane Bajraktari
- Drita Krasniqi

- **Rifat Hoxha**
- **Festim Tafolli**
- **Anera Alishani**
- **Leonora Sopaj**
- **Marigona Geci**

#### **FAKULTETI JURIDIK**

- **Halim Bajraktari**
- **Kadri Kryeziu**
- **Arif Riza**
- **Armend Podvorica**
- **Muharrem Faiku**
- **Enver Buqaj**
- **Shefki Shtërbani**
- **Dardan Vuniqi**
- **Simeana Beshi**
- **Driola Susuri**
- **Kastriote Vlahna**

#### **FAKULTETI I FILOLOGJISË**

- **Shkelqim Millaku**
- **Sermin Turtulla**
- **Teuta Kafexholli**
- **Kimete Canaj**
- **Flamur Shala**
- **Sejdi Sejdiu**
- **Vjollca Dibra**
- **Izer Maksuti**
- **Xhafer Beqiraj**
- **Ilir Krusha**
- **Ismet Bujupaj**
- **Dorinë Rakaj**

## **BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

Bashkëpunimi ndërkombëtar për Universitetin e Prizrenit është prioritet. Për faktin që me anë të ndërkombëtarizimit dhe krijimit të partnerëve, Universiteti ynë do të përfitojë përvoja nga Universitetet me traditë dhe Universitetet e zhvilluara. Konsiderojmë se mobiliteti i stafit akademik dhe administrativ, po ashtu edhe i studentëve është shumë i rëndësishëm për faktin se shkëmbehen përvoja të rëndësishme në aspektin akademik, hulumtues dhe menaxherial, që krijojnë mundësi për t'u përgjigjur sfidave të kohës.

Në vitin 2019 është hartuar Plani Strategjik për ndërkombëtarizim. Objektivat Strategjike të Ndërkombëtarizimit janë: Ndërkombëtarizimi i stafit akademik dhe i studentëve; Ndërkombëtarizimi i kurrikulave dhe programeve të studimit; Ndërkombëtarizimi i kërkimit; Anëtarësimi në asociacione ndërkombëtare dhe standardizimi i cilësisë; Rrjetëzimi akademik dhe kërkimor ndërkombëtar; Profilizimi rajonal dhe ndërkombëtar. Këto objektiva strategjike të ndërkombëtarizimit zërthehen në rezultatet e pritura për Universitetin.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, Universitetit në këtë periudhë ka kontaktuar një numër të universiteteve në regjion dhe më gjerë. Me disa nga Universitetet kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërsa me disa të tjerë jemi në fazën e bisedimeve.

Universiteti nënshkroi marrëveshje të ndryshme dhe memorandume mirëkuptimi me partnerë dhe organizata përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare. Përgjegjësitë e partnerëve përcaktohen qartë në marrëveshjet zyrtare. Më poshtë është lista e institucioneve me të cilat Universiteti ynë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Të gjitha kontratat e bashkëpunimit vihen në dispozicion në internet në faqen zyrtare të Universitetit.

1. KÜTAHYA DUMLUPINAT UNIVERSITY, TURQI
2. University System of Georgia, SHBA
3. University System of Georgia, SHBA
4. Universiteti Anadolu, Turqi
5. Universiteti Eskişehir Technical, Turqi
6. Universiteti Marmara, Turqi
7. University of Sarajevo, Bosnie dhe Hercegovinë
8. Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëri
9. Bursa Technical University, Turqi

10. Universiteti Namik Kemal, Turqi
11. Universiteti Bezmialem Vakif, Turqi
12. Universiteti Afyon Kocatepe, Turqi
13. Universiteti "Eqrem Çabeja", Gjirokastër / Shqipëri
14. Universiteti Istanbul Arel, Turqi
15. Universiteti Balikesir, Turqi
16. Universiteti Recep Tayyip Erdogan, Turqi
17. Universiteti Trakya, Turqi
18. Protokoll i Programit të Shkëmbimit Mevlana (Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Isparta), Turqi
19. Universiteti European i Tiranës, Shqipëri
20. Universiteti i Tiranës, Shqipëri
21. Kolegji i Bujqësisë dhe Shkencave të Jetës së Universitetit Kombëtar Chungnam, Koreja e Jugut
22. Universiteti ĘSB, Poloni
23. OeAD GmbH-Austri
24. Universiteti i Camerino-s, Itali
25. Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Isparta, Turqi
26. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Shqipëri
27. Sivas Cumhuriyet Üniversitesi, Turqi
28. DOKUFEST - Festival i filmit të shkurtër dhe dokumentar

## **PROJEKTET AKTIVE**

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren ka qenë pjesë e shumë projekteve ndërkombëtare që nga themelimi i tij.

Projektet janë financuar kryesisht nga Komisioni Evropian nën ERASMUS + nën programin e ngritjes së kapaciteteve KA-2. Në të gjitha projektet, Universiteti ynë ka marrë pjesë si institucion partner.

## **PROJEKTI I**



## **Zhvillimi dhe zbatimi i një programi PhD në TIK për Sistemin edukativ të Kosovës 2019-22**

### **Përmbledhje**

Megjithë ndryshimet gjithnjë e më të përshpejtuara në vendin e punës, përfshirë zgjerimin e shpejtë të aksesit teknologjik dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit që bën përmirësim gjithnjë e më shumë, sistemi arsimor në Kosovë nuk është i zhvilluar sa duhet për të siguruar arsimim të një cilësie të lartë të bazuar në hulumtime në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit. Duke u ballafaquar njëkohësisht me prioritetet e ndryshme kombëtare, Kosovës, këtij vendi të vogël me 2 (dy) milion banorë dhe me një buxhet kombëtar prej vetëm 2.3 miliardë, i mungojnë investimet e nevojshme për të transformuar rrënjësisht cilësinë e sistemit arsimor.

Një program doktore i financuar nga TIK-u do të adresonte përparësitë dhe kërkesat e sotme të fuqisë punëtore. Dizajni dhe shpërndarja e një programi kombëtar të PhD në TIK është thelbësor për Kosovën në mënyrë që të sigurojë gatishmëri konkurruese brenda sistemeve arsimore rajonale dhe ekonomive kombëtare të Ballkanit Perëndimor, dhe më gjerë. Ky punim argumenton nevojën për programe PhD dhe ofron njohuri për një projekt të propozuar, qëllimi i të cilit është vendosja e Kosovës në hartë duke ofruar një PhD në fushën e TIK-ut.

### **PROJEKTI II**

#### **Krijimi i Qendrave nga Teoria në Praktikë për Inovacion dhe Punësim 2017-20**

Ky projekt synon të përmbush objektivat duke krijuar Qendra nga "Teoria në Praktikë" (T2P) në institucionet e arsimit të lartë në të gjitha komunitetet në Kosovë, në bashkëpunim me partnerë nga industria vendore dhe institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe profesional. Synimi i T2P-së do të jetë sigurimi i një forumi për inovacion, shkëmbim të njohurive ndërmjet studiuesve (teorisë) dhe ndërmarrjes (praktikës), ngritja e kapaciteteve dhe krijimi i mjeteve të reja që adresojnë të gjithë akterët kryesorë të rëndësishëm për zhvillimin lokal dhe punësimin.

### **PROJEKTI III**

## **SMART4ALL**

Drejtoria e Përgjithshme për Rrjetet, Përmbajtjen dhe Teknologjinë e Komunikimit - 2019-2022

### **Përmbledhje**

Konsorciumi SMART4ALL është i përbërë nga 25 (njetetë e pesë) partnerë evropianë me aftësi dhe njohuri ndërdisiplinore nga Universitetet, institutet kërkimore, investitorët, qendrat e inovacionit dhe OJQ-të; pjesë e këtij konsorciumi është edhe Universiteti i Prizrenit.

- Projekti do të ndërtojë kapacitetet ndërmjet palëve të interesuara brenda BE-së përmes zhvillimit të eksperimenteve të vetëpërmbajtjes, ndërmjet vendeve që transferojnë njohuri dhe teknologji ndërmjet akademisë dhe industrisë.
- SMART4ALL synon CLEC (sistemet kibernetike fizike)/IoT (Interneti i gjërave) CLEC dhe kombinon një seri karakteristikash unike që bashkojnë kulturat, politikat, zonat gjeografike dhe fushat e aplikimit në një vision të përbashkët.

Fushat e synuara për aplikim janë:

- digjitalizimi i transportit,
- digjitalizimi i agrokulturës,
- digjitalizimi i mjedisit dhe
- digjitalizimi i çdo gjëje.

## **PROJEKTI IV**

**Përmirësimi i Kulturës së Kërkimit në Arsimin e Lartë në Kosovë – ResearchCult 2019-22**

### **Përmbledhje**

Bazuar në fushëveprimin e tyre si dhe nga dispozitat e ligjit të arsimit të lartë, universitetet janë të detyruara të ndërmarrin veprimtari kërkimoro-shkencore në fushat që ato mbulojnë. Në këtë kontekst, ky projekt është një projekt strukturor kombëtar i përqendruar kryesisht në universitetet në Kosovë, përkatësisht udhëheqjen (menaxhmentin dhe stafin akademik) qendrore dhe të departamenteve si dhe personelin akademik dhe studiuesit.

Universitetet në Kosovë, siç u shpjegua më parë, kanë mungesë të veprimeve institucionale dhe mekanizmave për të mbështetur veprimtarinë e vazhdueshme në kërkimin shkencor. Është shumë e nevojshme që të ndërmerren veprime të caktuara në koordinim me autoritetet kombëtare, siç është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për një qasje strategjike, e cila përqendrohet në këtë projekt, në masa të caktuara që do të rrisin cilësinë dhe sasinë e

kërkimit në sektorin e arsimit të lartë në Kosovë.

Pjesëmarrja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në projekt, si një nga partnerët kryesorë, do të mundësojë një koordinim më të mirë kombëtar të këtyre përpjekjeve të përbashkëta. MASHT-i do të mbështesë gjithashtu mobilizimin e universiteteve partnere për një mirëkuptim të përbashkët dhe dakordimin e masave kombëtare që synojnë këtë projekt për zhvillimin e kapaciteteve kërkimore në një perspektivë të periudhës afatmesme deri në një perspektivë të periudhës afatgjate. Kur është e nevojshme, MASHT-i do të udhëzohet të rishikojë politika të caktuara (ligjore dhe strategjike) vetëm për të lehtësuar zhvillimin dhe prezantimin e masave të tilla të synuara nga ky projekt.

Për më tepër, ky projekt strukturor pritet të zhvillojë struktura dhe politika të reja universitare të cilat mund të ndikojnë te shumica (nëse jo te të gjithë) e partnerëve të universitetit në rishikimin apo miratimin e akteve të tyre, dhe zhvillimin e rregulloreve të reja në lidhje me fushëveprimin e qendrave kërkimore, komiteteve të etikës kërkimore, revistave shkencore, etj.

## PROJEKTI V

### **Zhvillimi cilësor i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe menaxhimit të projektit QUADIC 2019-22**

#### **Përmbledhje**

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të përmirësojë sigurimin e arsimit të lartë në Kosovë dhe në Shqipëri duke ndërtuar kapacitete institucionale për marrëdhëniet ndërkombëtare, duke krijuar ose duke krijuar zyra përkatëse plotësisht funksionale (përfshirë kapacitetin për menaxhimin e ciklit të projektit) në të gjithë anëtarët e konzorciumit, tetë nga Kosova dhe pesë nga Shqipëria.

Ky projekt do të ndërtojë kapacitete institucionale për ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë në Kosovë dhe Shqipëri dhe do të përmirësojë aftësinë për zhvillimin dhe menaxhimin e projektit përmes ekspertizës ndërkombëtare të disponueshme nga institucionet evropiane të arsimit të lartë që partnerizojnë në këtë projekt dhe përmes shkëmbimit të praktikave të mira midis anëtarëve të konsorciumit. Kjo do të bëjë që institucionet vendore të arsimit të lartë të përfshihen me vetëbesim në nisma të ndryshme bashkëpunimi akademik dhe kërkimor në rajon, në Evropë dhe më gjerë.

## **Konferencat në rang kombëtar dhe ndërkombëtar**

Universiteti ka organizuar konferenca dhe aktivitete të tjera kërkimore dhe shkencore, në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. Më poshtë është lista e konferencave të viteve të fundit dhe një përshkrim i shkurtër për secilën konferencë. Të gjitha informacionet e nevojshme publikohen rregullisht në faqen zyrtare të universitetit përpara konferencës:

Dhjetor 2019 - Në Fakultetin e Filologjisë të universitetit u mbajt Konferenca shkencore kushtuar Prof. Abdullah Zymberit, gjuhëtarit, leksikologut, mbledhësit të leksikut popullor të gjuhës shqipe për 40 vjet, i cili punën e tij e shënoi në disa libra botimesh. Konferenca mbledhi dhjetëra studiues nga Tirana e Prishtina, nga Prizreni e Shkodra dhe nga qendra të tjera të Kosovës.

26 gusht 2019 - Në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren mbajti punimet Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me tematika të ndryshme nga Shkencat e Natyrës dhe Teknologjia, Shkencat e Jetës dhe Teknologjia dhe nga Shkencat Inxhinierike dhe Teknologjia. Kjo konferencë organizohet nga Universiteti me partnerët, UBT-në, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Isparta dhe Universiteti Ndërkombëtar i Vizionit. Në Konferencë marrin pjesë 150 akademikë dhe Rektorë, nga Turqia, Polonia, Italia, Kroacia dhe Shqipëria.

25 qershor 2019 - Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “The East of the East and East of the East” e mbajtur më herët në Prizren, Pragë - Republika Çeke dhe Ohër - Maqedoni, sivjet përsëri po mbahet në Prizren, kryeqyteti kulturor i Ballkanit. Kjo konferencë organizohet nga Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren në bashkëpunim me universitetet turke, Universitetin e Trakyas, Universitetin Hakari si dhe Universitetin e Muglas. Përveç të gjitha studimeve krahasuese në Lindje dhe Perëndim edhe punime nga fushat e tjera do të prezantohen me 26 dhe 27 qershor 2019. Për pjesëmarrje në konferencë janë dërguar gjithsej 112 abstrakte, prej të cilave janë pranuar gjithsej 76 abstrakte me autorë të vetëm, si dhe bashkautorë. Pjesëmarrësit janë nga Republika e Turqisë.

## **Mobiliteti i stafit dhe studenteve**

Universiteti është duke inkurajuar vizibilitetin ndërkombëtar të stafit dhe studentëve të saj duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në programe të ndryshme studimore mobiliteti, forume, organizime, punë praktike, shkolla verore, seminare, etj. Profesorët dhe stafi administrativ kanë

marrë pjesë në mësimdhënie dhe punëtori në të gjithë Evropën dhe më gjerë. Më poshtë është lista e mobilitetit të stafit dhe studentëve që kanë marrë pjesë në programe mobiliteti, me 2019.

	Stafi akademik	Stafi administrativ	Studentët	Kanë ardhur	Kanë shkuar
1	(5M – 1F) - 6	2 M	1M + 2F= 3	2	9
2		Veprimi IBC-M-K2	Gjermani  (mobilitet njëvjeçar)	Universiteti i Prizrenit	Universiteti i Anadolu-t, Turqi  Universiteti i Vjenës, Austri  Veprimi IBC-M-K2
3			Austri (mobilitet tremujor)		
4			Bullgari  (mobilitet tremujor)		
5	GJITHSEJ = 11				

### **Sigurimi dhe ngritja e cilësisë**

Gjatë vitit 2019 Universiteti ka rishikuar dhe azhurnuar të gjitha proceset, politikat dhe sistemin e sigurimit të cilësisë. Universiteti ka themeluar zyrën e Sigurimit të Cilësisë dhe ka emëruar shefin e zyrës dhe zyrtarin për sigurimin e cilësisë. Të dy pozitat janë pozita me orar të plotë. Universiteti gjithashtu ka rishikuar qëllimet strategjike të sigurimit të cilësisë dhe ka hartuar një rregullore për sigurimin e cilësisë, e cila përcakton qartë strukturën, përgjegjësitë dhe proceset jetësore të sigurimit të cilësisë.

Universiteti ka emëruar Komitetin për Sigurim të Cilësisë. Vendimi i emërimit i bashkëngjitet raportit.

Menaxhmenti i lartë i Universitetit ka themeluar departamentin për sigurimin e cilësisë për ta rritur kështu rolin e zyrës.

Detyrat dhe përgjegjësitë e departamentit dhe të punonjësve të departamentit përcaktohen qartë dhe publikohen në web-faqen e Universitetit. Detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha strukturave të sigurimit të cilësisë përcaktohen qartë në rregulloren për sigurimin e cilësisë.

Universiteti gjatë këtij viti ka hartuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) instrumente për sigurimin e cilësisë. Universiteti vlerëson dhe promovon performancën e stafit të saj akademik nëse kontribuon në mënyrë aktive në ndërtimin e urave të bashkëpunimit ndërkombëtar, dhe lejon që marrëveshjet me universitetet ndërkombëtare të lidhen. Njohja e kontributeve individuale është e përfshirë veçanërisht në procesin e vlerësimit në lidhje me stafin akademik. Më poshtë është formula e vlerësimit të stafit akademik që ndodh çdo semestër, duke filluar nga viti akademik 2019-2020:

Kriteret e vlerësimit	Përqindja
Vlerësimi nga studentët	20%
Vlerësimi i kolegëve	20%
Vlerësimi nga Dekani	20%
Publikime shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca	20%
Kontributi në Universitet dhe Kontributi në Shoqëri	20%
Gjithsej:	100%

### **Bordi Këshillëdhënës Industriale**

Universiteti ka hartuar dhe aprovuar Rregulloren për Themelimin dhe Parimet e Funkcionimit të Bordit Këshillëdhënës Industrial (BKI) të Njësive Akademike të Universitetit. Përveç kësaj, të gjitha njësitë akademike kanë krijuar, themeluar BKI-në. Qëllimi i BKI-së është bashkëpunimi midis njësive akademike dhe komitetit industrial. Kjo rregullore përcakton karakterin, anëtarësinë, funksionin, fushën e veprimit, mënyrën e vendimmarrjes dhe mandatin e BKI-së. Rregullorja është bashkëngjitur në pjesën e shtojcave të këtij raporti.

### **BUXHETI, FINANCAT DHE INFRASTRUKTURA**

Shpenzimi i buxhetit në vitin buxhetor 2019 për Universitetin e Prizrenit, për të gjitha kategoritë buxhetore, ka filluar nga muaji shkurt 2019, përveç për paga.

Buxheti fillestar i lejuar për vitin 2019 për kategorinë e shpenzimeve Paga dhe mëditje ishte 1,853,771.72 Euro (1,597,943.72 nga granti qeveritar-10 dhe 255,828.00 nga Të hyrat vetjake-21) dhe numri i lejuar i punëtorëve 143; Buxheti për Mallra dhe shërbime 600,000 Euro; për Shërbime komunale 73,000 Euro; për Subvencione dhe Transfere 100,000 Euro dhe për Kapitale 200,000 Euro. Pra, gjithsej **2,826,771.72 Euro**.

Në fund të vitit, të ballafaquar me tejkalimin e buxhetit për paga në Universitet, është "lejuar" rritja e buxhetit për paga që është bërë **1,993,505.93 Euro**, ndërsa realizimi ka qenë **2,249,353.83 Euro**, i rritur sërish për **255,847.90 Euro**.

Gjithashtu, për vitin 2019 Universiteti kishte në dispozicion edhe **19,451.33 Euro** donacione, Fondet burimore **31-99**.

Janë bërë kërkesa për rritjen e buxhetit për paga dhe rritjen e numrit të punëtorëve të lejuar me buxhet, por një gjë e tillë nuk është lejuar.

Në këtë analizë shpenzimit të buxhetit për vitin 2019 i jemi qasur me radhë, sipas kategorive të shpenzimeve të buxhetit.

Në këtë periudhë ka pasur shpenzime të donacioneve, të Donacionit të UE-së dhe atij të Qeverisë kroate.

Donacioni për Trashëgimi kulturore dhe FAITH ka përfunduar, sepse, sipas kërkesës së tyre, këtij të fundit i janë kthyer më 5 korrik 12,321.91 Euro.

U janë paguar bursat e mbetur pa paguar nga viti akademik 2018-2019 studentëve të dalluar,

nga fondet të cilat kanë qenë në dispozicion sipas buxhetit të lejuar për këtë vit.

Është mbyllur patty-cash-i (paraja e imët), është përpiluar Raporti i shpenzimit të parasë së imët dhe ai është barazuar me MASHT-MEF. Është kthyer në NLB cash i mbetur prej 134.44 Euro.

Në këtë analizë, natyrisht, është dhënë një pasqyrë e shpenzimit të buxhetit të lejuar nga BK-ja dhe nga Donacionet.

Gjatë përpilimit të këtij raporti, si zakonisht, i kam përdorur, kontrolluar dhe barazuar të dhënat zyrtare nga Free-balanci me gjendjen faktike, në cilësinë e Zyrtarit të autorizuar për pamje dhe raportim si dhe burime të tjera të cilat janë shënuar në faqen në vijim.

Në këtë raport, shpenzimet për të gjitha kategoritë e shpenzimeve janë dhënë edhe sipas nën kategorive të tyre, datave, muajve kur është kryer pagesa dhe emrave të përfituesve.

Të dhënat janë dhënë në formë standarde, të cilën e kemi krijuar vetë si të tillë dhe e cila jemi të sigurt se ofron transparencë maksimale.

Janë bartur për t'u paguar në vitin buxhetor 2020, **91,220 Euro** obligime të arritura pas skadimit të afateve për pagesë (Paga-77,463 Euro; Mallra - 13,748 dhe Komunale - 9. Euro).

### **Planet strategjike dhe Rregulloret që janë hartuar gjatë vitit 2019**

- **PLANI STRATEGJIK 2020-2024**
- **PLANI STRATEGJIK PËR KËRKIME SHKENCORE 2020 – 2024**
- **PLANI STRATEGJIK PËR NDËRKOMBËTARIZIM 2020-2024**
  
- **Rregullore për procedurat dhe masat për përpunimin dhe sigurinë e të dhënave personale**
- **Vendimi 01-65, Vendimi për Plotësimin dhe Ndryshimin e kodit të Etikes**
- **Doracaku i pakos së akteve ligjore për personelin akademik dhe administrativ**
- **Doracaku i studentëve në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren**
- **Udhëzuesi për vlerësimin e stafit akademik, vlerësimin e lëndës, dhe përdorimin e rezultateve të vlerësimit në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren**
- **Rregullore për përcaktimin e kritereve të studimeve themelore**
- **Rregullore për përcaktimin e kritereve të studimeve Master**
- **Rregullore e Punës së Senatit të Universitetit**
- **Rregullore për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetit "UKSHIN HOTI"**



- **Rregullorja për themelimin dhe parimet e funksionimit të Bordit Këshillëdhënës Industrial të Njësive Akademike të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren**
- **Rregullore e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtoreve të jashtëm në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren**
  - **Rregullore për sigurimin e cilësisë**
- **Rregullore për Shkollën Verore Ndërkombëtare**
- **Rregullore për kërkime shkencore**
- **Rregullore mbi themelimin dhe organizimin e qendrës së karrierës dhe Alumnit**
- **Rregullorja e punës së SMU-së dhe Limitet e saj**
- **Rregullore për shtëpinë botuese të Universitetit "UKSHIN HOTI" Prizren**

## Infrastruktura

Në Kampusin e Universitetit “Ukshin Hoti” janë këto Hapësira infrastrukturore: 4 - Amfiteatro me sipërfaqe S-1701 m<sup>2</sup>; 47 - Zyre të Stafit akademik dhe administrativ S-1423 m<sup>2</sup>; 9 - Laboratorë S-476 m<sup>2</sup>; 40 - Salla të Mësimit S-3068 m<sup>2</sup>; 3 - Biblioteka S-527 m<sup>2</sup>; 5 - kabinete të Informatikës S- 356 m<sup>2</sup>; dhe Hapësirat ndihmëse ( Holli, nyje sanitare, depot, arkiva dhe ngrohja qendrore) S- 7269m<sup>2</sup>. Totali i Përgjithshëm i sipërfaqeve të brendshme në Kampus është S-14820m<sup>2</sup>

## Hapësira infrastrukturore për një student

Totali i hapësirave infrastrukturore në Universitetin “Ukshin Hoti” është rreth 4m<sup>2</sup> për një student.




Figura 2: Kampusi dhe infrastruktura